

Çfarë është virusi HIV?

Virusi HIV është një virus që sulmon sistemin imunitar të trupit.

Sistemi juaj imunitar ju mbron nga sëmundjet. Nëse ai dëmtohet, ju sëmurëni. Infektimi me virusin HIV zhvillohet ngadalë. Ju mund të ndiheni të shëndetshëm për disa vite me radhë.

Por një infektion me virusin HIV që nuk trajtohet kalon në SIDA.

SIDA është një sëmundje vdekjeprurëse. Kur një person me virusin HIV kalon në SIDA, sistemi i tij imunitar dobësohet shumë.

Kjo mund të çojë në infeksione dhe sëmundje që kërcënojnë jetën.

Virusi HIV përhapet nëpërmjet kontaktit seksual dhe gjakut të infektuar. Prezervativët janë mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga virusi HIV.

Si zbulohet virusi HIV?

Simptomat janë shenjat e sëmundjes. Simptomat e HIV janë të ngjashme me ato të një infeksioni të zakonshëm.

Disa persona përjetojnë një periudhë të shkurtër me pak temperaturë, dhimbje fyti, gjëndra limfatike të fryra dhe skuqje të lëkurës disa javë pasi ata janë infektuar. Disa të tjerë nuk kanë fare simptoma dhe nuk kanë asnjë shenjë infektimi për disa vjet.

Ekziston mundësia që ju të jeni të infektuar me HIV dhe të infektoni të tjerët pa e ditur që e keni. E vetmja mënyrë për ta ditur me siguri është që të testoheni!

Mendoni se mund të jeni të infektuar?

Testohuni. Testi i virusit HIV është falas dhe ju jep një përgjigje përfundimtare!

Fshehtësia

Në Suedi, të gjithë personat që punojnë në shërbimet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen fshehtësisë. Kjo do të thotë se askush nuk ka të drejtë që t'i flasë personave të tjerë për ju, për gjendjen tuaj ose për mjekimin tuaj. Fshehtësia gjithashtu zbatohet edhe për përkthyesit.

Anonimiteti

Ju keni të drejtë që të mbeteni anonim kur kryeni një test për HIV. Kjo do të thotë se nuk është nevoja që të jepni emrin tuaj ose të tregoni kartën tuaj të pacientit. Nëse ju jeni të infektuar me virusin HIV, doktori do t'ju krijojë një kartë dhe do të kërkojë informacionin tuaj personal.

Ku duhet të shkoni

Ju mund të testoheni te:

- ▶ Qendrat e shërbimit shëndetësor.
- ▶ Qendrat e shërbimit shëndetësor për të rinjtë.
- ▶ Repartet e sëmundjeve infektive, dermatologjike dhe të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, nëpër spitale.
- ▶ Repartet e gjinekologjisë.
- ▶ Qendra shëndetësore Flyktinghälsan në Malmö.

Testimi për virusin HIV është tejet i rëndësishëm!

Kryerja e testit për virusin HIV është falas dhe ju jep një përgjigje të sigurt!

Kujdesi dhe trajtimi nuk kushtojnë asgjë.

Ju mund të mbeteni anonimë.

Prezervativët janë mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga virusi HIV.



Si mjekohet virusi HIV dhe SIDA në Suedi?

Virusi HIV nuk mund të mjekohet. Por ekzistojnë ilaçe anti-retrovirale, të cilat mund të forcojnë sistemin tuaj të imunitetit dhe të ngadalësojnë infeksionin.

Në Suedi, këto barna janë falas.

Mbrohuni!

Prezervativët janë mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga virusi HIV. Prezervativët ju mbrojnë gjithashtu dhe nga sëmundjet e tjera seksualisht të transmetueshme. Prezervativët nuk duhen dëmtuar dhe duhet të përdoren gjatë të gjithë aktit seksual!

Smittskyddslagen (Akti për Sëmundjet e Transmetueshme)

Suedia ka një ligj për të pakësuar përhapjen e sëmundjeve infektive, Smittskyddslagen (Akti për Sëmundjet e Transmetueshme). Sipas këtij ligji, ju duhet të kërkonit ndihmë mjekësore nëse mendoni se jeni të infektuar me virusin HIV. Ju gjithashtu duhet të kryeni testet dhe të jepni kampionët që ju kërkon doktori.

Kjo është shumë e rëndësishme për të parandaluar përhapjen e virusit HIV.

Nëse keni virusin HIV, ju duhet

t'ia tregoni këtë partnerit tuaj seksual.

Është përgjegjësia juaj

që të mos i infektoni të tjerët.

Si përhapet virusi HIV?


- Nga seksi i pambrojtur.
- Nga kontakti i drejtpërdrejtë me gjakun e infektuar.
- Nga përdorimi i përbashkët i gjilpërave të injeksioneve.
- Nga nëna te fëmija gjatë lindjes ose gjatë ushqimit me gji.

Jetesa me virusin HIV

Një person me virusin HIV mund të jetë i shëndetshëm për shumë vjet. Ju mund ta vazhdoni jetën në mënyrë normale dhe madje të keni edhe marrëdhënie seksuale. Megjithatë, është e rëndësishme që të përdorni një prezervativ dhe t'i tregoni partnerit tuaj se ju keni virusin HIV. Në Suedi barnat anti-retrovirale ofrohen pa pagesë.

Çdokush mund të infektohet me virusin HIV

Burra dhe gra, të rinj dhe të moshuar. Çdokush mund të infektohet nga virusi HIV dhe ai gjendet kudo në botë. Në Suedi, çdokush mund të testohet dhe barnat anti-retrovirale dhe trajtimi mjekësor janë pa pagesë.



Ju nuk mund të infektoheni nga:

- Kontakti me lëkurën, nga përqaqimet, ledhatimet ose nga prekja.
- Nga përdorimi i përbashkët i enëve të kuzhinës, nga ushqimi ose pijet.
- Përdorimi i përbashkët i një saune ose notimi në të njëjtën pishinë.
- Nga përdorimi i së njëjtës banjë ose dush.

Bëni një test për HIV për t'u siguruar

- Doktori merr një kampion të thjeshtë gjaku.
- Rezultatet dalin për rreth një javë.
- Në Suedi marrja e një testi për HIV ofrohet pa pagesë.
- Nuk ju kushton asgjë që të merrni kujdes dhe trajtim nëse keni virusin HIV.



Ku duhet të drejtoheni për informacione, për këshilla dhe për ndihmë

Shumë qendra mund t'ju ofrojnë informacion dhe t'iu përgjigjen pyetjeve tuaja. Çdokush që punon në shëndetësi është i detyruar të ruajë fshehtësinë dhe ju keni të drejtë të mbeteni anonimë.

1177 – Linja telefonike e kujdesit shëndetësor numri direkt 1177 | www.1177.se

Kjo linjë telefonike dhe faqja e internetit ofrojnë informacion në 24 orë nëse ju ose dikush nga të afërmit tuaj ndihet i sëmurë. Ju flisni me një infermiere me përvojë. Ju mund të mbeteni anonimë. Ju mund të telefononi në numrin 1177 nga kudo brenda vendit. Për emergjencë me rrezik për jetën, telefononi në numrin 112.

Flyktinghälsan in Malmö

040-623 97 00

www.skane.se/varcentralenflyktinghalsan

Qendra shëndetësore Flyktinghälsan ofron ekzaminime mjekësore për azilkërkuesit dhe për të afërmit emigrantë, si dhe kujdes mjekësor për azilkërkuesit. Çdokujt që kërkon kujdes shëndetësor këtu i ofrohet një përkthyes.

Qendrat shëndetësore të kujdesit parësor dhe qendrat shëndetësore për të rinjtë në Skåne

www.skane.se/primarvarden

Kujdesi parësor është një emër kolektiv për të gjitha mjediset e kujdesit shëndetësor në Skåne. Ky sajt rendit të gjitha adresat, numrat e telefonave dhe URL-të e qendrave shëndetësore për të rriturit dhe për të rinjtë.

Centrum för sexuell hälsa (Qendra e Shëndetit Seksual) në Malmö

040-33 17 47

www.sexuellhalsa.umas.se

Qendra ofron këshillim, testim dhe trajtim të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Ato kanë gjithashtu mami që ofrojnë këshilla mbi kontrollin e lindjes. Qendra mirëpret pacientë nga i gjithë Skåne.

Qendrat shëndetësore për të rinjtë

www.umo.se | www.skane.se/ungdomsmottagningen

Qendrat shëndetësore për të rinjtë janë për personat me moshë 12-23 vjeç në bashkinë e tyre. Ato ofrojnë këshillim, testim dhe trajtim të virusit HIV dhe të sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme.

Organizatrat vullnetare në Skåne që punojnë për parandalimin e virusit HIV

Noaks ark

040-611 52 15/042-24 31 00

www.noaksark.org/skane

Positiva Gruppen Syd

040-791 61 | www.pgsyd.nu

Projekt HBTre

042-28 13 99 | www.hbtre.se

RFSL Rådgivningen Skåne

040-611 99 51 | www.rfslradgivningen.se

RFSL Kristianstad

044-10 65 90 | www.rfsl.se/kristianstad

RFSU

040-30 57 00 | www.rfsu.se/malmo

Studiefrämjandet

046-211 77 50

www.studieframjandet.se/mittskane

Internationella kvinnoföreningen

040-79 474

www.ikf.se

Projekt sex P6

046-13 63 63

www.projekt6.se

U-n-I You and I

www.karen.mah.se/uni

